

Formulari- F2**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 592
Datë: 23/04/2025

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER**

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/ Programi	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment
Projektpropozimi	TRAJTIMI TERMIK PAS SALDIMIT TË GYPAVE NËN PRESION
Kandidati	Haki Morinaj
Mentori	Prof.Dr. Hysni Osmani
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 02.05.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.:632/3-13
Vlerësimi i dorëshkrimit	

Propozon

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Raportin për vlerësimin e punimit për master me titull: "TRAJTIMI TERMIK PAS SALDIMIT TË GYPAVE NËN PRESION", i kandidatit Haki Morinaj, bachelor i inxhinierisë mekanike, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë, 23.04.2025

Komisioni:

- Hosni Osmani
/ Prof.Dr. Hysni Osmani – mentor/
- Mirlind Bruçi
/ Prof.Dr. Mirlind Bruçi – anëtar/
- Nexhat Qehaja
/ Prof.Dr. Nexhat Qehaja – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës. Vendi, data dhe nënshkrimet vijnë në fund.

ABSTRAKTI

Trajtimi termik pas saldimit (PWHT - Post Weld Heat Treatment) është një proces i rëndësishëm në industrinë e përpunimit të metaleve, i cili synon të zvogëlojë tensionet e mbetura, të përmirësojë vetitë mekanike dhe të rrisë jetëgjatësinë e materialit. Ky punim diplome trajton ndikimin e trajtimit termik në gypat metalikë pas saldimit, duke analizuar ndryshimet strukturore dhe mekanike që ndodhin si rezultat i këtij procesi.

Në këtë studim, janë shqyrtuar teknikat kryesore të trajtimit termik, si ngrohja dhe ftohja e kontrolluar, si dhe parametrat kryesorë që ndikojnë në efektivitetin e këtij trajtimi, përfshirë temperaturën, kohëzgjatjen dhe llojin e materialit. Eksperimentet dhe analiza e mikroskopisë metalografike kanë treguar se trajtimi i duhur termik ndihmon në reduktimin e brishtësisë, përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe parandalimin e plasaritjeve të mundshme në nyjet e salduara.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se aplikimi i saktë i trajtimit termik pas saldimit është thelbësor për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e gypave në aplikime të ndryshme industriale.

Në përfundim, ky punim ofron rekomandime praktike për optimizimin e këtij procesi, duke ndihmuar në përmirësimin e performancës së materialeve të salduara.